

Kurs online: Mobilizimi i palëve të interesuara për reforma të suksesshme strukturore

KONSULTIMI I PALËVE TË INTERESUARA NË KONTEKST TË PRE-SË

Procesi i përgatitjes së PRE-së përshkruhet në Dokumentin Udhëzues që Komisioni Evropian e publikon çdo vit. Ekipet e vendeve janë të detyruara të organizojnë një proces të konsultimit publik mbi draftin e PRE-së, ta përshkruajnë atë dhe ta paraqesin si Shtojcë të PRE-së.

Fragment nga Dokumenti Udhëzues për PRE

»Për të pasur pronësinë dhe mbështetjen më të gjerë të mundshme politike, është shumë me rëndësi që të përfshihen dhe të konsultohen edhe palë të tjera të interesuara si komuniteti i biznesit, partnerët socialë dhe shoqëria civile, parlamenti kombëtar dhe autoritetet rajonale dhe lokale. Këta aktorë në mënyrë ideale duhet të përfshihen gjatë gjithë procesit dhe të konsultohen për i) analizën e pengesave për konkurrencën dhe rritjen përfshirëse të identifikuar nga qeveria, ii) raportimin mbi zbatimin e udhëzimeve të synuara të politikave dhe programeve të mëparshme të reformave, dhe iii) identifikimin dhe formulimin e reformave kryesore. Sidoqoftë, së paku drafti i parë i plotë i PRE-së duhet të jetë subjekt i konsultimit publik me ç'rast drafti bëhet publik për së paku dy javë. Ky konsultim publik duhet të nisë jo më vonë se me 22 nëntor për të lejuar kohë të mjaftueshme për të përfshirë komentet në draft. Duhet të zhvillohen edhe konsultime adekuate me organizatat e partnerëve socialë në përputhje me mekanizmat kombëtarë të konsultimit trepalësh.

7. ÇËSHTJET INSTITUCIONALE DHE PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESUARA (MAX 1 FAQE)

Përfshirja dhe pjesëmarrja e të gjithë aktorëve është thelbësore për të siguruar pronësinë dhe për të mundësuar progresin në zbatimin e udhëzimeve dhe reformave të politikave. Ky seksion duhet të shpjegojë procesin institucional për përgatitjen dhe miratimin e Programit të Reformës Ekonomike, si dhe për konsultimin publik. Seksioni duhet të përmbajë informacione mbi:

- Ministrinë e qeverisë dhe agjencitë e përfshira në proces dhe mënyra se si koordinatori ka gjykuar mes interesave të ndryshëm.
- Procesi me të cilin autoritetet rajonale dhe lokale janë përfshirë në përgatitjen e programit dhe në zbatimin e udhëzimeve dhe zotimeve të politikave të kaluara.
- Kur u prezantua programi në Parlamentin kombëtar dhe rezultati i diskutimeve.
- Procesi përmes të cilit janë konsultuar partnerët socialë (shoqatat e punëdhënësve dhe sindikatat) dhe shoqëria civile në përgatitjen e programit dhe komentet e tyre kryesore dhe shkallën se sa janë marrë parasysh komentet e tyre.

Përveç shpjegimeve të dhëna në këtë pjesë, vendeve partnere u kërkohet të përfshijnë komentet kryesore të shoqërisë civile dhe çdo kontribut me shkrim nga palët e jashtme të interesuara në Shtojcën 2. Ky seksion nuk duhet të jetë më i gjatë se 1 faqe.”



PRE duhet t'i nënshtrohet një konsultimi të jashtëm specifik dhe të veçantë, duke u dhënë palëve të interesuara mundësi dhe kohë të mjaftueshme për të komentuar për draft versionin e PRE-së."

Në mënyrë që të informoni lexuesit për të gjitha pjesët e informacionit të kërkuar, këshillohet të përdorni draftin e tekstit të personalizuar të mëposhtëm për "dokumentin një-faqesh":

Modeli i mundshëm për PRE Kapitulli 7: ÇËSHTJET INSTITUCIONALE DHE PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESUARA

Cikli i Programit të Reformës Ekonomike (PRE) 202_-202_ filloi zyrtarisht nga Komisioni Evropian më ___ 202_ (kur).

PRE 202_-202_ u përgatit në bashkëpunim të ngushtë në mes të këtyre ministrive: Ministrisë së Financave; Ministrisë së Infrastrukturës, Ministrisë së Energjisë; Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Shkencës, Ministrisë së Mjedisit, _____, si dhe agjencive të mëposhtme qeveritare: _____ dhe bankës qendrore (çfarëdo që të jetë e zbatueshme).

Autoritetet rajonale dhe lokale (përmendni disa _____) ishin përfshirë në përgatitjen e programit dhe zbatimin e tij nga _____ (data dhe përmbajtja).

Dekreti i Kryeministrit Nr. _____, datë _____ përcakton kornizën për koordinimin e procesit të PRE-së në nivelin kombëtar dhe përcakton Ministrinë e _____ me funksionin e Koordinatorit Kombëtar për PRE. Në këtë rol, koordinatori ka gjykuar ndërmjet _____ (shënoni çështjet kontestuese kryesore dhe mënyrën se si janë zgjidhur ato).

PRE u paraqit në Parlamentin kombëtar (emërtoni organin / komisionin e saktë) më _____ (data) dhe rezultati i diskutimeve ishte (shënoni konkluzionet kryesore).

Përveç pjesëmarrësve të përmendur qeveritarë, rajonalë, lokalë dhe parlamentarë, në procesin e përgatitjes u konsultuan edhe këto palë të interesuara:

- partnerët socialë (shoqatat e punëdhënësve dhe sindikatat - shënoni ato, datën e konsultimit / prezantimit)
- shoqëria civile (OJQ, OSHC - shënoni ato, me data)
- ndonjë konsultim tjetër? (odat ekonomike, ambasadat e huaja, organizatat ndërkombëtare, projekti FISR, partnerët e zhvillimit dhe integritit, shoqatat e biznesit, universitetet) nga _____ (data) deri më _____ (data).

Të gjitha reagimet, komentet dhe sugjerimet e marra si pjesë e procesit të konsultimit me palët e interesuara i janë dërguar ministrisë së linjës / agjencisë përgjegjëse për shqyrtim dhe përfshirje, sipas diskrecionit të tyre, në kontributet e rishikuara të tyre në PRE. Shtojca II përfshin të gjitha komentet kryesore që janë marrë gjatë këtij procesi të konsultimit, si dhe reagimet për komentet kryesore dhe shkallën në të cilën ato janë marrë parasysh.

Për **Shtojcën II**, këshillohet të përdoret një draft tabelë me këto fusha:

Fusha vërejtjeve	Komenti shpjeguar	Kontribuar nga cila palë e interesuar	Statusi komentit (pranuar / refuzuar)	Komenti (sidomos nëse refuzohet)
Të përgjithshme				
Kapitulli 2				
Masa nr. 16				

Jeni të lirë të përdorni formatin sipas zgjedhjes suaj.

Ju lutem vini re se PRE është dokument i politikës qeveritare. Ai gjithsesi duhet të diskutohet nga palë të ndryshme të interesuara, por përgjegjësia përfundimtare për suksesin ose dështimin e planit të masave të politikave ekonomike dhe zbatimin e tyre është në duart e qeverisë.